



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. 165 / 2025
Datë: 22/12 / 2025

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7, 01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 65 paragrafit 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe paragrafit 4 të nenit 11 të Rregullores nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M
për transferimin e përhershëm të nëpunës civil për interes të institucionit

1. Znj. Feride Podvorica nga pozita aktuale “Drejtor i Departamentit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira”, në Ministrinë e Drejtësisë, për interes të institucionit transferohet përhershëm brenda të njëjtës kategori të shërbimit civil, në pozitën “Drejtor i Departamentit Ligjor” në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Në zbatim të Rregullores ZKM-Nr. 10/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Drejtësisë, për shkak të domosdoshmërisë së plotësimit të kësaj pozite, në pajtim me legjislacionin në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.
3. Obligohet njësia përgjegjëse për Burime Njerëzore dhe njësia përgjegjëse për Buxhet dhe Financa që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi dhe pagesën e nëpunës sipas pagës së pozitës për të cilën është transferuar.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Në zbatim të Rregullores ZKM-Nr. 10/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Drejtësisë, për shkak të domosdoshmërisë së plotësimit të pozitës dhe në interes të institucionit, është vlerësuar dhe është vendosur transferimi i përhershëm i nëpunës civile znj. Feride Podvorica, brenda së njëjtës kategori të shërbimit civil, nga pozita

aktuale “Drejtor i Departamentit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira”, në Ministrinë e Drejtësisë, në pozitën “Drejtor i Departamentit Ligjor” në Ministrinë e Drejtësisë.

Në mbështetje të nenit 65 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenit 11 të Rregullores nr.02/2024 për transferimin e nëpunësve civil, për shkak të domosdoshmërisë së plotësimit të kësaj pozite, në pajtim me legjislacionin në fuqi, dhe pas marrjes së pëlqimit nga nëpunësja civile, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi i'u dërgohet:

- Znj. Feride Podvorica;
- Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Buxhet dhe Financa;
- Divizionit të Burimeve Njerëzore;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.